



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 141 Prot.
16

Patos më 01 .02.2024.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 29.01.2024

I mbajtur sot më datë 29.01.2024 në orën 13:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë :

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltars:

1. Albiona Lamaj
2. Armand Ahmetaj
3. Klaudio Alisinanaj
4. Erald Çepele
5. Artan Velçani
6. Ertilla Myrtaj
7. Renaldo Shpata
8. Vjollca Kasaj
9. Novrus Toska
10. Smerald Hazizaj
11. Liljana Mesutaj
12. Eduart Faslliaj
13. Elmira Rama
14. Enkelejda Ajazi

Rendi i ditës

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 18.12.2023.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 18.12.2023.
- 4- Informacion mbi "Raportin vjetor të Transparencës dhe Konsultimeve Publike" nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
- 5- Informacion mbi "Inventarët jashtë përdorimit" nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social.
- 6- Projekt-vendim "Për dhënie e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin dhjetor 2023".
- 7- Projekt-vendim "Për dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin dhjetor 2023".
- 8- Projekt-vendim "Për miratimin e kategorizimit të niveleve të përfaqësimit të studentëve dhe nxënësve në olimpiadat kombëtare e ndërkombëtare dhe masën e shpërblimit të tyre.

- 9- Projekt-vendim “Për miratimin e kategorizimit të niveleve të përfaqësimit të studentëve dhe nxënësve në kampionatet kombëtare e ndërkombëtare dhe masën e shpërblimit të tyre.
- 10-Projekt-vendim “Për një shtesë në VKB nr. 41 datë 27.07.2023 “ për rishqyrtimin , miratimin dhe përbërjen e kryesisë së komisioneve të përhershme”
- 11-Projekt-vendim “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërvendore për menaxhimin e landfillit (depozitim, peshim, mirëmbajtje e rrugës hyrëse) në impiantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier.

Takimi hapet nga Kryetari i Këshillit Z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Të pranishëm në mbledhje janë 14 këshilltarë, kuorumi ligjor është i plotë.

Zhvillojmë sot këtë mbledhje në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar përkatësisht neni 53 , dhe 53, 58 të “Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin të Këshillit Bashkiak”.

Paraprakisht dua ti uroj këshillit punë të mbarë për vitin 2024! Gjithashtu uroj t’ja keni kaluar mirë më festat!

Mbledhjen e deklaroj të hapur, filloj me leximin e rendit të ditës.

1- Miratimi i rendit të ditës.

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 18.12.2023.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 18.12.2023.

4- Informacion mbi “Raportin vjetor të Transparencës dhe Konsultimeve Publike” nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

5- Informacion mbi “Inventarët jashtë përdorimit” nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social.

6- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin dhjetor 2023”.

7- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin dhjetor 2023”.

8- Projekt-vendim “Për miratimin e kategorizimit të niveleve të përfaqësimit të studentëve dhe nxënësve në olimpiadat kombëtare e ndërkombëtare dhe masën e shpërblimit të tyre.

9- Projekt-vendim “Për miratimin e kategorizimit të niveleve të përfaqësimit të studentëve dhe nxënësve në kampionatet kombëtare e ndërkombëtare dhe masën e shpërblimit të tyre.

10-Projekt-vendim “Për një shtesë në VKB nr. 41 datë 27.07.2023 “ për rishqyrtimin , miratimin dhe përbërjen e kryesisë së komisioneve të përhershme”

11-Projekt-vendim “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërvendore për menaxhimin e landfillit (depozitim, peshim, mirëmbajtje e rrugës hyrëse) në impiantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier.

Armand Ahmetaj- Nëse keni ndonjë pyetje?


Shkëlqim Beqiraj- Kryetar të lutem nëse ka mundësi pikën 11 mund ta kalojmë në pikën 10 pasi mua me duhet të lëviz nga vendi i punës.

Armand Ahmetaj- Atëherë i lutem këshillit meqënëse nga ekzekutivi ka një angazhim tjetër pikën 11 ta shqyrtojmë në pikën pesë.

Armand Ahmetaj- Kush është dakord me rendin e ditës?

14 Pro, asnjë kundër, abstenim asnjë, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba



KRYETARI
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 171 Prot.

Patos më 01.01.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.01.2024 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 18.12.2023.

Armand Ahmetaj- Nëse ka ndonjë diskutim, pyetje apo sygjërim për korrigjim procesverbali?

Atëherë ska, kisha unë meqënëse dhe një këshilltarë e ka vënë re. Është një lapsus i vogël që ka të bëjë me prezencën e këshilltarëve, Sekretarja ta korrigjojë ose ta pasqyrojë në një dokument që të jemi në rregull me të tjerat.

Nëse ska pyetje ose sygjërimë në bazë të nenit 77 të rregullores e konsiderojmë të miratuar procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

SEKRETARI

Refaela Xeba

Edlira Myrtaj Ahmetaj
Renelda Shyreta
Eduart Fashaj

KRYETARI

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 171/Prot.
18

Patos më, 01 02.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.01.2024 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 18.12.2023.

Armand Ahmetaj – Të lutem sekretare!

Refaela Xeba , Përshëndetje të gjithëve! Në mbledhjen e datës 18.12.2023 janë marrë gjithsej 10 vendime nga numrat 76 deri në 85, të gjitha vendimet janë zbardhur në afat ashtu siç është e përcaktuar në ligj dhe rregullore dhe janë përcjell drejtorisë përkatëse për ekzekutim.

Nga këto 10 vendime vendimi nr. 81 dhe 82 ishin me karakter normativ, të cilët i janë përcjell prefekturës për verifikim dhe me shkresë nr. 1303/1 prot datë 03.01.2024 ka ardhur përgjigja se vendimet janë në përputhje me ligjin.

Gjithashtu më lejoni t'ju informoj se nga ana e prefekturës kemi pasur një kontroll në vend në datën 04.12.2023, ku objekti i kontrollit ishte verifikimi i akteve normative të organit përfaqësues dhe organit ekzekutiv të Bashkisë Patos, për periudhën shtator-nëntor 2023 si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Prefekti i Qarkut Fier në përfundim të verifikimit në vend të zhvilluar në muajin shtator 2023 .

Nga kontrolli i ushtruar përfundimet janë si më poshtë vijon:

Nuk ka akte normative të Këshillit Bashkiak të padepozituara për verifikim tek Prefekti i Qarkut Fier.

Nuk ka akte normative të kthyer në kundërshtim me ligjin.

Nuk ka vendime të dërguara për pavlefshmëri në gjykatë.

Projekt-vendimet janë të numërtuara me numër progresiv.

Procesverbali i mbledhjeve mbahet në përputhje me ligjin.

Nuk ka rekomandime të lëna në kontrollin e kaluar

Armand Ahmetaj , Po faleminderit!

Armand Ahmetaj- Faleminderit! Atëherë vazhdojmë me pikën e radhës.

SEKRETARI

Refaela Xeba

KRYETARI

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 171/Prot.
19

Patos më 01.01.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.01.2024 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Informacion mbi “Raportin vjetor të Transparencës dhe Konsultimeve Publike” nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Armand Ahmetaj- Atëherë përfaqësuesi i ekzekutivit të relatoj në lidhje me këtë pikë.

Suzana Hyenaj Koordinatore e Konsultimit Publik- relaton materialin përkatës të paraqitur në këshill.

Armand Ahmetaj- Të ishte pak më e koncentruar, nëse ka ndonjë problematik sepse besoj se materialin këshilltarët e kanë lexuar.

Suzana Hysenaj- Është vetëm informacion lidhur me gjithë detyrën që ka bërë këshilli dhe ekzekutivi së bashku për realizimin e dëgjësave publike.

Armand Ahmetaj- Po pra, po si jemi? I kemi realizuar mirë apo jo?

Suzana Hysenaj- Patjetër çdo gjë është e realizuar.

Në datën 18 korrik ne kemi pasur për shkak të zgjedhjeve vendore nuk kemi pasur realizimin e dëgjësave publike gjatë muajit maj, duke qënë se ka qënë dhe pjesë e fushatave zgjedhore kështu që e kemi vazhduar pjesën e dëgjësave publike të muajit maj në muajin korrik. Koordinator i konsultimit publik relaton datat e dëgjësave publike sipas materialit të paraqitur.

Armand Ahmetaj- Kemi ndonjë pyetje? Jo skemi.

SEKRETARI

Refaela Xeba

KRYETARI

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 110/Prot.
15

Patos më 01 01.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.01.2024 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Kalojmë në votim ashtu si ramë dakord për Projekt-vendim “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërvendore për menaxhimin e landfillit (depozitim, peshim, mirëmbajtje e rrugës hyrëse) në impiantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier.

Armand Ahmetaj - I lutem ekzekutivit!

Nurkë Hazizaj – Përgjegjëse e Sektorit Juridik- Sikurse keni dijeni me Vendimin nr. 64 këshilli i Bashkisë datë 30.10.2023 miratojë kontratën e qirasë 1 euro, të lidhur midis bashkive të qarkut dhe agjenciasë së administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara. Po me këtë projekt vendim u autorizua dhe Kryetari i Bashkisë për të negociuar me bashkitë e qarkut për mënyrën e menaxhimit të landfillit. Në datën 16.01.2024 është nënshkruar marrëveshja “Për bashkëpunimin ndërvendore për menaxhimin e landfillit (depozitim, peshim, pastrim & mirëmbajtjen e rrugës hyrëse).

Kjo marrëveshje është nënshkruar ndërmjet Bashkisë Fier, Bashkisë Patos, Roskovec, Lushnje, Divjakë dhe Mallakastër.

Qëllimi i marrëveshjes është realizimi i një nga funksioneve kryesore të parashikuara në ligjin Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” e cila ka të bëjë me mbledhjen, trajtimin dhe largimin e mbetjeve urbane. Së dyti një qëllim tjetër i kësaj marrëveshjes është menaxhimi i përbashkët i mbetjeve urbane përsa i përket pjesës së depozitimit peshimit dhe rrugës hyrëse në impiantin e mbetjeve urbane të qarkut Fier.

Së treti një qëllim tjetër është përcaktimi i një strukture të përbashkët për kryerjen e kësaj veprimtarie, duke i deleguar kompetencat dhe përgjegjësitë e veçanta dhe duke marrë përsipër angazhimet financiare në përputhje me përqindjen e përcaktuar në marrëveshje. Palët kanë rënë dakort që menaxhimi i impjantit do të kryhet nga Sektori i posaçëm i cili do të funksionojë pranë ndërmarrjes së pastrimit të bashkisë Fier i cili do të ketë në përbërje të tij 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës.

1 përgjegjë sektori.

2 manovrator.

4 punonjës peshore.

8 punëtor lanfilli.

Për sa i përket kontributit financiar mujor për mbulimin e shpenzimeve të nevojshme për funksionimin e sektorit e shprehur në përqindje % për bashkinë Patos do të jetë 8.7 % dhe pagesa do të bëhet brenda një afati 30 (tridhjetë) ditor nga momenti i depozitimit të faturës në rrugë zyrtare. Një nga detyrat që të gjitha bashkitë marrin përsipër është që transporti i mbetjeve me mjetet e veta nga territori i tyre ose nga pika e transferimit drejt depozitimit pranë impiantit të mbetjeve urbane.

Përsa i përket afatit të marrëveshjes kjo marrëveshje do të ketë afat vlefshmërie po aq sa është kohëzgjatja e kontratës së qirasë 1 euro, por palët kanë rënë dakord që kjo marrëveshje mund ta

tejkalojë këtë afat deri në përfundimin e dorëzimit të impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane tek bashkitë e qarkut. Një nga detyrat e tjera që bashkitë kanë ka të bëjë me marrjen me qira të një automjeti i cili është një automjet i rëndë që do të shërbejë funksionimit të impiantit. Palët kanë rënë (kur them palët e kam fajlën për bashkitë) dakord që të autorizojnë Bashkinë e Fierit për të realizuar gjithë procedurat për marrjen me qira të automjetit dhe do të marrin përsipër në përputhje me përqindjet e parashikuara shpenzimet për këtë automjet. Ekzekutivi pasi mori në shqyrtim përmbajtjen dhe kushtet e parashikuara në marrëveshje me propozim të Kryetarit të Bashkisë mbështetur në ligjin nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr. 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane", ligjit nr. 10440 datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 319, date 03.05.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane" vendimit nr. 64, datë 30.10.2023 me propozim të Kryetarit të Bashkisë i kërkojmë këshillit të bashkisë:

Të miratojë marrëveshjen protokolluar pranë bashkisë Patos nr.110 prot., datë 10.01.2024 "Për miratimin e marrëveshjes,

Efektet financiare do të mbulohen nga fondet e trashëguara.

Për ndjekje dhe zbatimin e kësaj marrëveshje ngarkohet Agjencia e Shërbimeve Publike Patos.

Artan Velçani- Në emër të Komisionit të Shërbimeve Publike, Zhvillimi Urban, Ndërtimet dhe Pronat i cili u mbledh në datën 25.01.2024 në orën 15.00 për shqyrtimin e këtij projekt vendimi dhe arriti në këtë konkluzion, u ra dakord që përmbajtja e projekt-vendimit është argumentuar në përputhje me ligjin si dhe Komisioni vendosi ta miratoi pa asnjë ndryshim.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër para se të kalojmë në votim? Atëherë kalojmë në votimin e pikës së pestë projekt-vendim "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërvendore për menaxhimin e landfillit (depozitim, peshim, mirëmbajtje e rrugës hyrëse) në impiantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier.

Kush është dakord?

12 vota pro, 2 abstenim, kundër ska, miratohet.


SEKRETARI

Refaela Xeba



KRYETARI

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 2521 Prot.
/ 3

Patos më 21 .01.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.01.2024 ora 13:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Informacion mbi “Inventarët jashtë përdorimit” nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social.

Mimoza Shtëmbari –Drejtoresh e Financës dhe Ndihmave Sociale. Përshëndetje të gjithëve!
Ekzekutivi relaton materialin e paraqitur në Këshill.

Armand Ahmetaj- Faleminderit! Kemi ndonjë pyetje? Atëherë nuk kemi, kalojmë në pikën tjetër.

SEKRETARI
Refaela Xeba

KRYETARI
Armand Ahmetaj

Renaldo Shpata
Edmont Foshtaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 135 Prot.
3

Patos më 31.01.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.01.2024 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin dhjetor 2023".

Barie Goxhaj- Për muajin dhjetor 2023 për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë sektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike gjithsej 26 familje me një fond prej 78,156 (shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.

Armand Ahmetaj – Ka ndonjë pyetje? Diskutim?

Armand Ahmetaj -Atëherë kalojmë në votim për miratimin e pikës së shtatë të rendit të ditës. Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin dhjetor 2023".

Kush është dakord?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

KRYETARI
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 134 Prot.
3

Patos më 01.01 2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.01.2024 ora 13:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin dhjetor 2023”.

Barie Goxhaj- Për muajin dhjetor 2023 nga fondi i kushtëzuar propozojmë të përfitojnë ndihmë ekonomike gjithsej 24 familje me një fond prej 106,107 (njëqind e gjashtë mijë e njëqind e shtatë) lekë.

Armand Ahmetaj – Keni ndonjë diskutim për këtë pikë para se të kalojmë në votim?

Atëherë kalojmë në votim nëse nuk kemi diçka tjetër për miratimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin dhjetor 2023”.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

KRYETARI
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 145 Prot.
14

Patos më 01.02 2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.01.2024 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e kategorizimit të niveleve të përfaqësimit të studentëve dhe nxënësve në olimpiadat kombëtare e ndërkombëtare dhe masën e shpërblimit të tyre.

Elda Goxhaj- Drejtore e Integritimit Evropian, Arsimit, Kulturës dhe Sporteve. Përshëndetje të gjithëve!

Në mbështetje të shkronjën “k”, neni 54, shkronjës “c”, neni 64, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në pikën 4, shkronja “b”, të nenit 28 të ligjit nr. 69/2012 “Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë;

Të miratojë kategorizimin e niveleve të përfaqësimit të studentëve dhe nxënësve në olimpiadat kombëtare e ndërkombëtare dhe masën e shpërblimit sipas tabelës.

Bashkia Patos ka miratuar në Buxhetin 2024, në programin buxhetor “Arsimi i Mesëm”, zërin buxhetor “ Stimulimi financiar i nxënësve ekselentë”, me një vlerë prej 220.000 lekë.

Bashkia synon të mbështesë nxënësit dhe studentët që marrin pjesë dhe vlerësohen në kampionate sportive, duke nxitur dhe duke i orientuar këto kategori drejt angazhimit në disiplina të ndryshme sportive.

Armand Ahmetaj – Meqënëse kjo pikë është ezauruar në mbledhjen e komisionit dhe këshilltarët u shprehën se e kanë lexuar materialin, unë propozojë ta kalojmë në votim.
Atëherë kalojmë në votim.

Kush është dakord për projekt-vendimin “Për miratimin e kategorizimit të niveleve të përfaqësimit të studentëve dhe nxënësve në olimpiadat kombëtare e ndërkombëtare dhe masën e shpërblimit të tyre?

Armand Ahmetaj - Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

KRYETARI

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 146 / 4 Prot.

Patos më 01.02 2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.01.2024 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e kategorizimit të niveleve të përfaqësimit të studentëve dhe nxënësve në kampionatet kombëtare e ndërkombëtare dhe masën e shpërblimit të tyre.

Elda Goxhaj- Drejtore e Integritimit Evropian, Arsimit, Kulturës dhe Sporteve. Ju kërkoj ndjesë se ju lexova projekt vendimin për kampionatet, për olimpiadat po e lexoj tani. Është e njejta gje, niveli i përfaqësimit është i njejti, kategorizimi është i njejti .

Armand Ahmetaj – Po ju informoj se dhe ky projekt vendim ka kaluar në komisionin e Arsimit dhe i ka kaluar këshillit me tre vota pro.

Nëse keni pyetje?

Erald Çepele- Kisha një pyetje në lidhje me fondin, nga do të mbulohen këto shpenzime?

Elda Goxhaj- Në buxhetin e 2024 është zeri buxhetor, ne e kemi përmendur dhe në projekt vendim është një zë buxhetor i cili quhet stimulimi financiar i nxënësve ekselentë”, me një vlerë prej 220.000 lekë. Ne kemi aktualisht kërkesë të një nxenseje e cila ka fituar vendin e dytë në olimpiadë. Është folur me drejtorinë e Financës nëse do të ketë një alokim. Me lejoni tju jap një informacion në lidhje me fituesit. Kemi një nxense e cila ka fituar vendin e dytë në olimpiadë, masa e shpërblimit është kombëtrae dyzetë mijë lekë. Kemi dhe grupin e të rinjëve në shkollën “Zhani Ciko” të cilët kanë fituar vendin e parë në festivalin e shkencës në Shqipëri dhe do përfaqësojnë Shqipërinë në Finlandë në muajin maj.

Armand Ahmetaj - Kush është dakord për Projekt-vendimin “Për miratimin e kategorizimit të niveleve të përfaqësimit të studentëve dhe nxënësve në kampionatet kombëtare e ndërkombëtare dhe masën e shpërblimit të tyre.

Armand Ahmetaj - Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

KRYETARI
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 144 / 2 Prot.

Patos më 01 .02.2004.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.01.2024 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për një shtesë në VKB nr. 41 datë 27.07.2023 “ për rishqyrtimin , miratimin dhe përbërjen e kryesisë së komisioneve të përhershme”

Armand Ahmetaj – Për tju përshtatur zhvillimeve të reja që kanë të bëjnë me zhvillimin europian edhe bashkia jonë ka menduar të ngrejë Komisionin e Integritit. Kompetenca është e kryetarit të këshillit sipas rregullores. Komisioni përbëhet nga pesë antarë.

Kam menduar të propozojë këshilltarë të cilët janë pjesë e vetem një komisioni, pra për të shpërndarë dhe pak ngarkesën e punës.

Propozimi im është Z. Novrus Toska, Znj Lori Musaj, Znj. Liljana Mesutaj Z. Renaldo Shpata dhe Z. Zejni Musaj.

Kush është dakord me përbërjen e komisionit? Ka ndonjë propozim për kryetarin e komisionit?

Renaldo Shpata- Për kryetar të këtij komisioni unë propozojë Z. Novrus Toska.

Armand Ahmeta- Kush është dakord me përbërjen dhe kryetarin?

Armand Ahmetaj - Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

Kryerari deklaroi mbledhjen të mbyllur.

SEKRETARI
Refaela Xeba

KRYETARI

Armand Ahmetaj

Renaldo Shpata

Eduart Fasthaj